



Pranimi / Dorezimi / Prilipi / Prilipi / Prilipi / Prilipi		24. 12. 2020		viti / viti / viti / viti	
Organ / Rreth / Org. / Org. / Org. / Org.	In. Prof. / In. Prof. / In. Prof. / In. Prof.	Shtojca / Prilog / Appendix	Sasia / Krahuna / Quantity		
SKINSHK 3302/2020				113	



## Republika e Kosovës

### Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova  
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A. Nr. 365/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A. Nr.365/2020, të datës 19.11.2020, të parashtruar nga ankuesi [REDACTED], me adresë banimin rruga „ Bajraku i Lumes”, fshati Zhur, Komuna e Prizrenit, kundër organit të punësimit Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.12.2020, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A. Nr. 365/2020, e datës 19.11.2020, e parashtruar nga ankuesi [REDACTED].
- II. Anulohet masa disiplinore “Vërejtja me shkrim” Nr. 37A/20 e datës 30.09.2020, e shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë së Arsimit, në Komunën e Prizrenit ndaj ankuesit, si dhe çdo veprim tjetër i pasuar lidhur me masën disiplinore.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës së Prizrenit për zbatimin e këtij vendimi, në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

[REDACTED], Zyrtar i Lartë për Standarde dhe Vlerësim, Sektori i Arsimit, Drejtori e Arsimit në Komunën e Prizrenit, me datë 19.11.2020 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” e



shqiptuar me datë 30.09.2020 nga Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prizrenit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 26.11.2020, me numër protokollit 2768/2020 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prizrenit, ndërsa me datën 15.12.2020, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë, me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për vërtetim e gjendjes faktike si dhe vendosje meritore ka administruar këto prova:** Ankesën A nr.365 /2020 e datës 19.11.2020, me numër protokollit 2648/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimin i datës 10.12.2019; e-maili i datës 05.11.2020; kalanderi Mujor i muajit korrik (2020); Vërejtje me shkrim e datës 30.09.2020; deklaratë e datës 30.09.2020; kërkesë për sqarim e datës 01.09.2020; raporti i punës për muajin shtator; Planifikimi i Punës për muajin mars; Plani tre mujor i punës; raport i datës 23.10.2020; Ankesa e datës 28.10.2020, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kalendari i Aktiviteteve për muajin Korrik; e-maili i datës 29.09.2020; e-maili i datës 30.09.2020; Deklaratë e datës 30.09.2020; e-maili i datës 10.04.2020; Raporti i Punës për Muajin Shtator; Planifikimi i Punës për muajin mars; Planifikimi i Punës për muajin dhjetor; Përgjigje në ankesë e datës 15.12.2020, me numër protokollit 3157/2020, me shkresat e bashkangjitura, organogrami i Komunës së Prizrenit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa, *është e bazuar, sepse:*

Kolegji konstaton se janë plotësuar të gjitha kushtet për shqyrtimin e ankesës në kuptim të pranueshmerisë së saj, ashtu siç kërkohet me nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji, ka shtjelluar pretendimet ankimore të ankuesit, i cili pretendon se masa disiplinore e shqiptuar nga Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prizrenit, nuk është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

Nga shkresat e lëndës Kolegji ka konstatuar se Drejtori i Arsimit me datë 30.09.2020, bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, neni 66 paragrafi 1,2,3 dhe pika 3.2, neni 67 pika 1,2,3, ka shqiptuar ndaj ankesusit masën disiplinore "Vërejtje me shkrim", për shkak se ankuesi nuk ka hartuar kalendarin mujor sipas kërkesës së datës 28.06.2020 të Zyrës për Informim dhe Drejtoreshës së DKA-së.

Kundër kësaj mase disiplinore, ankuesi me datë 28.10.2020 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Komunës së Prizrenit, ku sipas përgjigjes në ankesë të datës 15.12.2020, ankuesi është udhëzuar që ti drejtohet Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Gjykatës Kushtetuese, ka konstatuar së Ligji Nr.06/-L-114 për Zyrtaret Publikë, ka hyrë në fuqi me datë 09.07.2020, dhe i njëjti në kuadër të kapitullit IV, ka rregulluar në mënyrë të veçantë çështjen e disiplinës në Shërbimin Civil. Andaj, duke marr parasysh këtë, Andaj, duke marr parasysh këtë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave vlerëson se Drejtori i Arsimit gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit, duke u thirrur në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.





Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave konstaton se bazuar ne nenin 85 të Ligjit NR. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj.

Nga provat e lëndës përkatësisht nga Akt Emërimi i datës 10.12.2019, organogrami i Komunës, përgjigja në ankesë si dhe sqarimet e datës 24.12.2020 te menaxherit të personelit të Komunës së Prizrenit, është vërtetuar se ankuesi si mbikëqyrës të drejtpërdrejt ka Udhëheqësin e Sektorit të Arsimit dhe jo Drejtorin e Arsimit. Andaj bazuar ne ketë rrethanë, Drejtori i Arsimit nuk ka qenë kompetente qe të shqiptoj ndaj ankuesit masën disiplinore "vërejtje me shkrim", si zyrtar në Sektorin e Arsimit dhe më këtë Drejtori i Arsimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili ka përcaktuar se "Kompetenca dhe procedura disiplinore 1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë".

Çdo akt administrativ i nxjerr në kundërshtim me dispozitat procedurale dhe materiale, konsiderohet si akt i paligjshme ashtu siç është përcaktuar më Ligjin 03/L- 031 për Procedurën e përgjithshme Administrative përkatësisht nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ku thuhet "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse 1.3 është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative" ..... 1.5 është në kundërshtim me ligjin material;

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës, i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga kryetarja e Kolegjit për shqyrtim dhe Vendosje të kësaj ankesë.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente- Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda Nr. A. Nr. 365/2020

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj -DEMI

Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit ██████████
- Kryetarit të Komunës së Prizrenit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prizrenit;
- Arkivit të KPMSHCK-së